



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.12.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:49 dhe mbaroi në orën 14:12.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Emona Muçi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Gentiana Muçaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>8. Markelian Koça</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>9. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim 1: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*, si dhe anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, *z. Alban Toro*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1

Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 28.12.2023

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Maela Alicanaj, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Edmond Hoxhaj, BIRN.*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ilir Rusi: Përshëndetje të nderuar anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Sipas njoftimit të bërë dhe për shkak të krijimit të kuorumit të nevojshëm, deklaroj të hapur mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, datë 28.12.2023, ora 13:30.

Ju bëj me dije që për arsye objektive dhe subjektive Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Llagami, nuk është prezent në këtë mbledhje dhe kështu që mbledhja në vijim do të drejtohet nga ana ime, Ilir Rusi Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor. Gjithashtu edhe z. Toro nuk është prezent për arsye objektive. Gjithashtu për arsye teknike, rezulton që zoti Kurushi është “online”, por faktikisht është prezent në këtë sallë plenare të kësaj mbledhjeje. Kështu që mbledhjen e deklaroj të hapur në vijimin e shqyrtimit të rendit të ditës.

Për më tej, sipas rendit të ditës, kemi të bëjmë me shqyrtimin e projektvendimit “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”, për të cilin është përgatitur relacioni nga Departamenti i Programimit, Administrimit dhe Buxhetit. Për më tej fjalën relatorit, z. Haxhiu.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit zoti Zëvendëskryetar!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”, është miratuar buxheti për Sistemin Gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), në shumën 4,967,459 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore, programi 01110, , programi 01140 dhe programi 03310.

Fondet buxhetore të miratuara për sistemin gjyqësor, për vitin 2024, siç e shikoni edhe përpara, janë sipas pasqyrës së mëposhtme dhe në total, siç e theksova më sipër janë në vlerën 4,967,459 mijë lekë dhe krahasuar me kërkesat buxhetore të cilat janë në shumën 7,331,450 mijë lekë rezultojnë më të ulëta në vlerën 2,363,991 mijë lekë, pra më pak se kërkesat buxhetore.

Për vitin 2024, për sistemin gjyqësor, me gjithë kërkesën tonë për 89 punonjës shtesë, nuk është miratuar asnjë punonjës shtesë.

Bazuar në legjislacionin për menaxhimin buxhetor, Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit, në bashkëpunim me Departamentin e Administrimit të Gjykatave dhe IT-së dhe Departamentin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative në KLGJ, ka përgatitur dokumentin përfundimtar të detajimit të fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2024, në Sistemin Gjyqësor (KLGJ/ Gjykata/ QTI), të ndara sipas programeve, të cilat po i evidentojmë shkurtimisht si më poshtë.

Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” që konsiston me fondet e programuara dhe miratuara për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Fondet për këtë program janë miratuar në shumën 381,059 mijë lekë dhe krahasuar me kërkesat buxhetore janë më të ulëta në shumën 140,091 mijë lekë, të cilat konsistojnë në 53,000 mijë lekë në shpenzime korrente dhe në 86,500 mijë lekë në shpenzime kapitale.

Në shpenzime korrente fondet janë detajuar si më poshtë:

Në shpenzime personeli (artikulli 600, 601 të cilët konsistojnë në shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore) janë detajuar në shumën 291,409 mijë lekë, dhe do të përdoren për pagat dhe sigurimet shoqërore për të gjithë administratën dhe punonjësit e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu në shpenzime operative, artikulli 602 “Mallra dhe shërbime të tjera”, janë detajuar në shumën 73,150 mijë lekë dhe janë parashikuar të përdoren për blerje “Materiale zyre dhe të përgjithshme”, “Materiale dhe shërbime speciale”, “Shërbime nga të tretë”, “Shërbime transporti”, “Shpenzime udhëtimi dhe dieta”, “Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme”, “Shpenzime për detyrime dhe kompensime legale” që ka të bëjë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, dhe “Shpenzime të tjera operative”.

Në shpenzime të tjera korrente, janë detajuar fonde në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individë, në shumën 1,500 mijë lekë, të cilat janë parashikuar të përdoren kryesisht për rimbursimin e pagesës sipas limitit të shërbimeve telefonike, për përfituesit sipas VKM-së përkatëse.

Në shpenzime kapitale (investime në Këshillin e Lartë Gjyqësor), fondet buxhetore janë miratuar në shumën 15,000 mijë lekë dhe janë parashikuar dhe detajuar të përdoren për blerje automjete dhe për sistemin Exchange server për hostimin e e-maileve zyrtare në infrastrukturën IT, për plotësimin e nevojave për ushtrimin e aktivitetit të KLGJ-së. Siç jeni në dijeni, hostimi i tyre do kalojë nga AKSH-i në serverat tanë në Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Programi 01140 “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë” – detajimi i fondeve buxhetore për këtë program u miratuan edhe sot në mbledhjen e bordit të QTI-së, të cilën po jua paraqes shkurtimisht.

Për vitin 2024, fondet për QTI-në janë miratuar në janë miratuar në shumën 16,800 mijë lekë, dhe janë që të gjitha në shpenzime korrente (detajuar për shpenzime paga, për shpenzime sigurime shoqërore, për shpenzime dhe mallra e shërbime të tjera).

Në shpenzime kapitale, siç tashmë juve jeni familjarizuar, shpenzime kapitale nuk akordohen sepse këto mbulohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek programi më i rëndësishëm që ka sistemi, në programin që zë edhe 92% të të gjithë buxhetit të sistemit gjyqësor, “Buxheti gjyqësor”, që ka të bëjë me buxhetin e të gjithë gjykatave të të tre niveleve.

Buxheti për sistemin gjyqësor për vitin 2024 për gjykatat është miratuar në shumën 4,569,600 mijë lekë, e cila krahasuar me kërkesën e bërë nga ana jonë gjatë tre

fazave të hartimit të PBA 2024-2026 e cila konsiston në vlerën 6,791,300 mijë lekë, janë miratuar më pak në shumën 2,221,700 mijë lekë.

Detajimi i fondeve buxhetore në këtë program është bërë si më poshtë:

Në Shpenzime korrente, që konsistojnë në shpenzime për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime të tjera për rimbursimin e kredive dhe të shpenzimeve të telefonisë celulare në të gjithë gjykatat. Këtu vlen të theksojmë që në detajimin e fondeve në shpenzime paga dhe sigurime shoqërore janë mbajtur parasysht disa kritere, siç është numri faktik i punonjësve, numri sipas strukturës organizative, numri i magjistratëve, mungesat në sistem (të shkarkuar ose të pezulluar me 75%) dhe disa vende të paplotësuara në administratën gjyqësore prej 190 vendesh vakante.

Në detajimin e fondeve është mbajtur parasysht edhe përfundimi i studimeve të magjistratëve të rinj të cilët pritet të emërohen në korrik nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, që numri i tyre për këtë vit buxhetor është 32 dhe janë detajuar fonde edhe për këtë qëllim (mbajtur të administruara në KLGJ 03310). Po kështu janë mbajtur edhe disa fonde në 03310 për plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor në administratën gjyqësore, të cilat do t'i shpërndahen gjykatave sipas nevojave të tyre gjatë vitit buxhetor.

Në artikullin 602 “Mallra dhe shërbime të tjera” fondet buxhetore janë detajuar në shumën 615,800 mijë lekë, të cilat krahasuar me kërkesën në shumën 681,700 mijë lekë, janë detajuar më pak fonde në shumën 65,900 mijë lekë, kushtëzuar kjo gjithmonë nga fondet e miratuara për këtë qëllim. Këto fonde janë detajuar duke pasur parasysht kërkesat e gjykatave në projektbuxhet; fondi buxhetor i akorduar për çdo gjykatë për vitin 2023, dhe realizimi i këtij fondi gjatë vitit buxhetor 2023; organika faktike e çdo gjykate; janë zbritur shpenzimet specifike të realizuara gjatë vitit, të cilat nuk do të përsëriten në vitin në vazhdim; fondet për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të lindura gjatë vitit 2023, si dhe të pashlyera gjatë vitit buxhetor 2023; si dhe fondet e Gjykatës së Lartë, fondet për mirëfunksionimin e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED).

Fondet buxhetore për këtë grup shpenzimesh, parashikohen të përdoren për:

“Materiale zyre dhe të përgjithshme”, “Materiale dhe shërbime speciale” “Shërbime nga të tretë”, “Shpenzime transporti”, “Shpenzime udhëtimi dhe dieta”, “Shpenzime mirëmbajtje të zakonshme”, dhe “Shpenzime të tjera operative”. Këtu siç u

theksua edhe më lart, do mbahen të administruara në 03310 disa shpenzime që kanë të bëjnë me disa shërbime që janë të administruara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor sipas propozimeve të bëra nga struktura përgjegjëse Departamenti i Administrimit të Gjykatave dhe IT dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative. I keni të detajuara si më poshtë.

Për shërbimin mirëmbajtje dhe zhvillime për sistemet e menaxhimit të çështjeve gjyqësore në gjykata; për mirëmbajtjen e sistemit regjistrimit audio RDA dhe “backup chain”, shërbim interneti, shërbim mirëmbajtje e programit financiar, shërbim për mirëmbajtje dhe licenca për rrjetin e klasifikuar, shërbim mirëmbajtje dhe zhvillime për programin “m-files”, shërbim mirëmbajtje, sistemi i njoftimeve “e-notification” (për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm), shërbim mirëmbajtje, regjistri i OJF-ve (për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë), shërbim mirëmbajtje e sistemit “disaster recovery” në Këshillin e Lartë Gjyqësor, shërbim, test i penetrimit për përforcimin e sigurisë kibernetike në rrjetin dhe infrastrukturat IT të gjykatave të Republikës së Shqipërisë, shërbimi i sigurimit dhe ruajtjes në gjykata.

Për vitin 2024, gjykatat kanë parashikuar të kenë në dispozicion edhe të ardhura të tyre të cilat në buxhet janë përlllogaritur të jenë rreth 39,000 mijë lekë, të cilat 32,000 mijë lekë do të përdoren për plotësimin e nevojave në shpenzime operative ndërsa 7,000 mijë lekë të përdoren për të plotësuar nevojat e tyre në investime nga secila gjykatë.

Po kështu, në artikullin 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, fonde buxhetore janë detajuar në shumën 6,100 mijë lekë të cilat parashikohen, siç e citova edhe më sipër, për t’u përdorur kryesisht për kompensime të shpenzimeve të telefonisë celulare dhe pagesat e interesit të kredisë për blerje apartamenti për qëllime banimi për gjyqtarët, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Detajimi i fondeve të miratuara në shpenzime kapitale (investime), artikulli 230 dhe 231, në programin “Buxheti i gjykatave”, fondet buxhetore janë detajuar në shumën 368,000 mijë lekë. Ndërsa kërkesat buxhetore për vitin 2024 ishin në shumën 1,845,300 mijë lekë, pra janë detajuar më pak në shumën 1,477,300 mijë lekë, gjithmonë kjo e kushtëzuar nga fondet e miratuara.

Detajimi i fondeve buxhetore të miratuara për vitin 2024, në shpenzime kapitale (investime) në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, sipas natyrës së investimeve dhe kodit të projektit, u krye duke mbajtur në vëmendje: projektet ekzistuese në vazhdim, nevojat e përvitshme për pajisje elektronike, nevojat për pajisje zyre, plotësimin e nevojave për rikonstruksionet e pjesshme sipas kërkesave të gjykatave dhe pasi janë vlerësuar edhe projektet e reja sipas prioriteteve. Detajimi i fondeve buxhetore në shpenzime kapitale, sipas kodeve, paraqitet sipas pasqyrës që ju të gjithë e keni përpara, por unë po e detajoj shkurtimisht.

Në “Studime, Projektme” fondi i miratuar është 28,000 mijë lekë dhe krahasuar me fondin që ne kishim kërkuar që ishte 68,000 mijë lekë, është miratuar shumë më pak (66,800 mijë lekë kishim kërkuar ne dhe ishte për hartimin e studimet e projekteve për disa godina të gjykatave të shkallëve të para kryesisht dhe dy gjykatat e apelit të Tiranës). Por duke qenë se vetëm për Gjykatën e Lartë ka mbaruar që vjet detyra e projektimit dhe jemi në pritje të miratimit të një sheshi ndërtimi, ne vlerësuam detajimin e këtij fondi për një hartimin e studim projektimin për Gjykatën e Lartë, pastaj sipas vazhdimësisë së vitit buxhetor do t’ju paraqitet dhe ju do informoheni në çdo moment.

Për “Ndërtime të reja dhe rikonstruksion të pjesshëm dhe të plotë”, janë detajuar fonde në vlerën 113,900 mijë lekë. Për ndërtime të reja, siç e theksova edhe juve jeni në dijeni, nuk janë detajuar fonde për arsye se, të mungesës së fondeve të miratuara, por se nuk janë hartuar projektet e zbatimit të cilat duhet të ishin hartuar mbasi të na ishin vënë në dispozicion sheshet e ndërtimit. Ndërsa për rikonstruksionet e plota dhe të pjesshme është detajuar e gjithë shuma prej 113,900 mijë lekë, është detajuar për këtë qëllim. Kjo është detajuar si më poshtë:

Për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm janë detajuar fonde në shumën 27,000 mijë lekë pasi gjykata kishte paraqitur një kërkesë për 112,990 mijë lekë për rikonstruksion të ambienteve të godinës ekzistuese. Nga informacionet që disponojmë dhe në bashkëpunim me gjykatën, u përcaktuan drejtimet kryesore të projektit të rikonstruksionit të paraqitur fillimisht, duke i dhënë prioritet punimeve për rikonstruksionin e rrjetit elektrik e kompjuterik, i cili rezulton të jetë i amortizuar dhe shpërndarja e energjisë elektrike nuk është në proporcionin e duhur. Pra për këto nevoja

urgjente gjykata paraqiti një preventiv të ri për këto lloj punimesh me vlerën 27,000 mijë lekë.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat janë detajuar fonde në shumën 1,700 mijë lekë për dhomën e serverit.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë detajuar fonde në shumën 2,400 mijë lekë për rikonstruksionin e tarracës.

Për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës janë detajuar fonde në vlerën 23,300 mijë lekë. Objekti i këtij investimi do të jetë realizimi i rikonstruksionit të godinës ekzistuese të gjykatës, por me projekt-idenë që ka paraqitur gjykata në një vlerë paraprake preventivuese ka paraqitur një vlerë dyfishin e kësaj e cila konsiston edhe në disa ambiente që është në negociatë edhe Këshilli i Lartë Gjyqësor me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Bashkinë Kukës për t'i marrë dhe për të plotësuar nevojat e gjykatës Kukës. Por duke qenë se kjo procedurë, kalimi në përgjegjësi administrimi të këtyre ambienteve nuk ka përfunduar në vlerësuam edhe nga mungesa e fondeve që të detajojmë një pjesë për këtë vit dhe pjesën tjetër për vitin buxhetor 2025.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë janë detajuar fonde në shumën 13,000 mijë lekë. Objekti i investimit është dhoma e serverit në zbatim dhe në përputhje me “Standardet për ndërtimin e dhomës së serverit në gjykata”.

Për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë janë detajuar fonde në shumën 16,500 mijë lekë. Objekti i investimit do të jetë rikonstruksioni dhe përshtatja e ambienteve të ndërtesës së ish-Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë për Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë si rezultat i hartës së re gjyqësore. Pavarësisht se nuk kishin paraqitur kërkesa gjatë vitit buxhetor u vlerësua për nevojat imediate për t'iu detajuar ky fond i domosdoshëm për rregullimin e ambienteve të kësaj gjykate.

Gjithashtu, në këtë projekt kemi mbajtur të pa detajuar një vlerë 30,000 mijë lekë të administruara në KLGJ 03310 e cila është vlerësuar të mbahet për nevoja gjatë vitit buxhetor për “Studime dhe projekte”, duke qenë se, siç e theksova edhe më sipër, për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka përfunduar detyra e projektimit dhe jemi në pritje

të dhënies së një sheshi ndërtimi për të cilin do të lindë nevoja direkt gjatë vitit për t'iu akorduar ky fond. Gjithsesi kjo do të jetë në gjykimin e Këshillit në një moment të dytë.

Për “Programe Software” kemi detajuar fondin buxhetor në shumën 116,000 mijë lekë, të cilat janë për projektin e digjitalizimit të dosjeve të arkivit gjyqësor (për t'u mbyllur edhe kjo, është viti i fundit dhe ka tre vite që po implementohet); për “disaster recovery”; për “infrastrukturën mbështetëse ICMIS të ri”; për “regjistrin e OJF-ve”; për “sistemin Exchange Server për hostimin e e-maileve e cila siç e theksova do financohet nga të dy programet sepse është pjesë edhe e Këshillit të Lartë Gjyqësor për pjesën prej 8%, ndërsa pjesa tjetër do financohet nga buxheti i gjykatave në vlerën 69,000 mijë lekë).

Gjithashtu, në investime, kemi detajuar fonde edhe për pajisje për plotësimin e nevojave për infrastrukturë elektronike, fonde të cilat janë detajuar në vlerën 50,000 mijë lekë. Në këtë fond do të administrohet në 03310 KLGJ dhe janë parashikuar të përdoren për plotësimin e nevojave për infrastrukturë, si server, switch, kompjuter, UPS serveri, UPS kompjuteri, printer, sisteme fonie, skaner, fotokopje, dhe ka të bëjë me kërkesat e bëra nga 18 gjykata të të tre niveleve që për efekt të kohës nuk po i citoj (i keni të gjithë në relacion).

Gjithashtu, janë detajuar fonde në investime edhe për “Blerje orendi dhe pajisje zyre” në shumën 30,000 mijë lekë. Edhe kjo krahasuar me kërkesat që kanë bërë gjykatat, që ishin shumë të mëdha, i kushtëzuar nga buxheti i miratuar, kemi detajuar vetëm këtë fond dhe ky fond do të përdoret nga 11 gjykata të të tre niveleve sipas kërkesave që ato kanë paraqitur pranë institucionit tonë.

Gjatë detajimit të fondeve buxhetore ne kemi pas edhe “Projektin e sigurisë në gjykata” në shumën 273,300 mijë lekë por duke qenë se buxheti i miratuar është shumë i vogël sesa buxheti i kërkuar, ishte e pamundur të detajonim fonde për këtë projekt. Gjithashtu, dua të theksoj se edhe në programin “software”, gjatë kërkesave buxhetore 2024-2026 ashtu si edhe në PBA 2023-2025 është kërkuar fond për “Projektin ICMIS i ri” në shumën 310,700 mijë lekë, por duke qenë se edhe për këtë projekt buxheti i miratuar është shumë më i vogël sesa buxheti i miratuar, ishim në pamundësi për të detajuar fonde edhe pse ky projekt siç dihet, për sistemin, është tejet i rëndësishëm.

Në fund, kemi detajuar fonde edhe për “Blerje të mjeteve motorike” për sistemin gjyqësor në shumën 30,000 mijë lekë, të cilat edhe këto do të administrohen në KLGJ 03310 dhe janë parashikuar të përdoren për blerjen e 10 automjeteve për përmirësimin e rinovimin e mjeteve të transportit në sistemin gjyqësor.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Departamenti i Administrimit dhe Programimit të Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi detajimin e buxhetit vjetor 2024 për sistemin gjyqësor dhe të taveve buxhetore për vitin 2025 dhe vitin 2026, sipas pasqyrave bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.
Faleminderit!

Ilir Rusi: Të falënderoj për relacionin zoti Haxhiu.

Ftoj anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor prezent në mbledhje nëse kanë diskutime apo pyetje mbi çfarë u parashtrua deri më tani nga zoti Haxhiu.

(Nuk ka diskutime apo pyetje.)

Meqenëse nuk ka diskutime apo pyetje, kalojmë në votimin e projektvendimit përkatës.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Ilir Rusi: Dakord.

Vendim “Për detajimin e buxhetit vjetor, viti 2024, për sistemin gjyqësor”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të bazës ligjore përkatëse, vendosi:

1. Miratimin e detajimit të buxhetit vjetor të vitit 2024 për sistemin gjyqësor (KLGJ, QTI dhe Gjykatat) dhe të tavanëve buxhetore për vitin 2025 dhe vitin 2026, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrës nr. 1, bashkëlidhur.

2. Miratimin e detajimit të fondeve buxhetore në programin 03310 Buxheti Gjyqësor, në Shpenzime kapitale (Investime) për vitin 2024, në nivel artikulli, projekti dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrës nr. 2, bashkëlidhur.

3. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës, e cila ishte e vetme, mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Pasdite të qetë!

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor